

20101182289

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TRASHËGIMINË JURIDIKE**  
**TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË ANËTARËSIMIT NË FONDIN MONETAR**  
**NDËRKOMBËTAR**

Neni 1

Në Ligjin për të drejtën e trashëgimisë së Republikës së Maqedonisë të anëtarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 23/93 dhe 52/2009), neni 2 ndryshohet si vijon:

"Në territorin e Republikës së Maqedonisë vlejnë dispozitat e Statutit të Fondit me ndryshimet dhe plotësimet nga 28 korriku 1969, 1 prilli 1978, 11 nëntori 1992, 28 prilli 2008, 5 maji 2008, si dhe nga 10 gushti 2009."

Neni 2

Teksti i ndryshimeve dhe plotësimet e Statutit të Fondit nga 10 gushti 2009 nga neni 1 të këtij ligji, janë pjesë përbërëse të këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**NDRYSHIMET E STATUTIT TË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR NGA 10**  
**GUSHTI 2009**

1. Në nenin XV, Seksioni 1 ndryshohet si vijon:

"(a) Për t'u plotësuar nevojat, si dhe kur ato paraqiten, për plotësimin e rezervave ekzistuese, Fondi është i autorizuar që t'u ndajë të drejta speciale të tërheqjes në pajtim me dispozitat nga neni XVIII anëtareve që janë pjesëmarrëse ne Seksionin për të drejta speciale të tërheqjes.

(b) Përveç kësaj, Fondi u ndan të drejta speciale të tërheqjes anëtareve që janë pjesëmarrëse ne Seksionin për të drejta speciale të tërheqjes, në pajtim me dispozitat e Shtojcës M."

2. Pas Shtojcës L shtohet Shtojca e re M si vijon:

"Shtojca M

Ndarja e veçantë e njëhershme e të drejtave speciale të tërheqjes

1. Varësisht nga 4-shi më poshtë, çdo anëtare e cila përfundimisht me 19 shtator 1997, është pjesëmarrëse në Seksionin për të drejta speciale të tërheqjes, në ditën e 30 pas datës së hyrjes në fuqi të ndryshimit të katërt të këtij statuti, merr ndarje të të drejtave speciale të tërheqjes me shumë e cila do të rezultojë në ndarjen e saj neto kumulative të të drejtave speciale të tërheqjes e cila është në shumë të barabartë me 29,315788813 % nga kuota e saj përfundimisht me 19 shtator 1997, me kusht që për pjesëmarrëset kuota e të cilave nuk është e përshtatur siç është propozuar në Rezolutën numër 45-2 nga Këshilli i Guvernatorëve, llogaritjet të bëhen në bazë të kuotave të propozuara në atë Rezolutë.

2. (a) Varësisht nga 4-shi më poshtë, çdo vend i cili bëhet pjesëmarrës në Seksionin për të drejta speciale të tërheqjes pas 19 shtatorit 1997, por në afat prej tre muajsh nga data e anëtarësimit të tij në Fond merr ndarje të të drejtave speciale të tërheqjes në shumë të llogaritur në pajtim me (b) dhe (c) më poshtë në ditën e 30 pas: (1) datës në të cilën anëtarja e re bëhet pjesëmarrëse në Seksionin e të drejtave speciale të tërheqjes, apo (2) datës së hyrjes në fuqi të ndryshimit të katërt të këtij statuti pa dallimin që do të ndodhë më vonë.

(b) Për qëllimet nga (a) më lartë, çdo anëtare e merr shumën e të drejtave speciale të tërheqjes e cila rezulton në ndarjen kumulative neto të pjesëmarrëses e cila është e barabartë me 29,315788813 % nga kuota e saj në datën në të cilën anëtarja bëhet pjesëmarrëse në Seksionin për të drejtat speciale të tërheqjes, siç është e përshtatur:

(1) e para, nëpërmjet shumëzimit të 29,315788813 % me përpjestimin e kuotave të përgjithshme, siç është llogaritur sipas 1 më lartë, të pjesëmarrëseve të përshkruara në (c) më poshtë dhe kuotave të përgjithshme të pjesëmarrëseve të atilla nga data në të cilën anëtarja bëhet pjesëmarrëse në Seksionin për të drejta speciale të tërheqjes, dhe

(2) e dyta, nëpërmjet shumëzimit të prodhimit nga (1) më lartë nëpërmjet përpjestimit të shumës së përgjithshme nga ndarja kumulative neto e të drejtave speciale të tërheqjes sipas nenit XVIII të pjesëmarrëseve të përshkruara në (c) më poshtë nga data në të cilën anëtarja bëhet pjesëmarrëse në Seksionin për të drejta speciale të tërheqjes dhe ndarjeve që pjesëmarrëset i kanë marrë sipas 1 më lartë me shumën e përgjithshme nga ndarja kumulative neto e të drejtave speciale të tërheqjes sipas nenit XVIII të pjesëmarrëseve të atilla përfundimisht me 19 shtator 1997 dhe ndarjeve që pjesëmarrëset e atilla i kanë marrë sipas 1 më lartë.

(c) Për qëllimet e përshtatjeve të cilat do të kryhen sipas (b) më lartë, pjesëmarrëset në Seksionin e të drejtave speciale për tërheqje janë anëtare të cilat janë pjesëmarrëse përfundimisht me 19 shtator 1997 dhe (1) mbeten të jenë anëtare në Seksionin e të drejtave speciale të tërheqjes prej datës në të cilën anëtarja bëhet pjesëmarrëse në Seksionin e të drejtave speciale të tërheqjes, dhe (2) i kanë marrë të gjitha ndarjet nga ana e Fondit pas 19 shtatorit 1997.

3. (a) Varësisht nga 4 më poshtë, nëse Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia/ Mali i Zi) e trashëgon anëtarësimin në Fond dhe pjesëmarrjen në Seksionin për të drejtat speciale të tërheqjes të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në pajtim me kushtet nga Vendimi i Këshillit Ekzekutiv numër 10237-(92/150), i miratuar më 14 dhjetor 1992, ajo merr ndarje të të drejtave speciale të tërheqjes me shumë të llogaritur në pajtim me (b) më poshtë në ditën e 30 pas: (1) datës në të cilën Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia/ Mali i Zi) e trashëgon anëtarësimin në Fond dhe pjesëmarrjen në Seksionin për të drejtat speciale të tërheqjes në pajtim me kushtet e Vendimit të Këshillit Ekzekutiv numër 10237 - (92/150), apo (2) datës së hyrjes në fuqi të ndryshimit të katërt të këtij statuti pa dallimin që do të ndodhë më vonë.

(b) Për qëllimet e (a) më lartë, Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia/ Mali i Zi) e merr shumën e të drejtave speciale të tërheqjes e cila do të rezultojë në ndarjen kumulative neto të barabartë me 29,315788813% nga kuota e cila i është propozuar sipas paragrafit 3 (c) nga Vendimi i Këshillit Ekzekutiv numër 10237 - (92/150), siç është përshtatur në pajtim me 2 (b) (2) dhe (c) më lartë nga data në të cilën Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia/Mali i Zi) kualifikohet për ndarjen sipas (a) më lartë.

4. Fondi nuk u ndan të drejta speciale të tërheqjes në pajtim me këtë shtojcë atyre pjesëmarrëseve të cilat nuk e kanë informuar Fondin me shkrim para datës së ndarjes për dëshirën tyre që të mos e pranojnë ndarjen.

5. (a) Nëse, në kohën kur kryhet ndarja të pjesëmarrësja në pajtim me 1, 2 apo 3 më lartë, pjesëmarrësja ka obligime të papaguara ndaj Fondit, të drejtat speciale të tërheqjes ashtu të ndara depozitohen dhe ruhen në llogari eskrou në Seksionin për të drejta speciale të tërheqjes dhe do t'i paguhet pjesëmarrëses pas plotësimit të të gjitha obligimeve të papaguara ndaj Fondit.

(b) Të drejtat speciale të tërheqjes të cilat ruhen në llogarinë eskrou nuk janë të kapshme për përdorim dhe nuk janë të përfshira në asnjë llogari të ndarjeve apo posedimeve të të drejtave speciale të tërheqjes për qëllimet e këtyre anëtarëve, përveç për llogaritjet sipas kësaj shtojcë.

(c) Për qëllimet e këtij paragrafi, obligimet e papaguara ndaj Fondit përbëhen nga blerje të përsëritura të vonuara dhe shpenzime në llogarinë e përgjithshme të mjeteve, kryegjëja e papaguar dhe kamata e huave në llogarinë speciale për pagesë, shpenzime të papaguara dhe vlerësime në Seksionin e të drejtave speciale të tërheqjes dhe obligime financiare të papaguara ndaj Fondit si kreditor.

(d) Përveç për dispozitat në këtë paragraf, duhet të zbatohet principi për ndarje ndërmjet Seksionit të përgjithshëm dhe Seksionit për të drejta speciale të tërheqjes dhe karakterit të pakusht të të drejtave speciale të tërheqjes si mjete rezerve."